

Diten e shtunë në orën 17:00 u bë hapja e Aktiviteti Multikulturor “Open Port Art Port” në mjediset e brendëshme të Portin e Durrësit. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm gjatë gjithë ditës 10.000 vizitorë të cilët vizituan ambjentet e brendëshme.

Në këtë ditë porti ishte i hapur për të gjithë qytetarët, të cilët ishin të lirë të bënin vizitë në të gjithë sektorët, për këtë i gjithë stafi i Autoritetit Portual Durres ishte i angazhua që të shoqëronte vizitorët në pika të ndryshme të portit: në Sheshin e Konteinerëve, Sheshin e para administrates, Kapiteneri, Zyrat e Forcës së Sigurisë përmes së cilës Porti i Durrësit monitorohet 24 orë, Reparti i Zjarrëfiksive (PMNZSH), dhe në kalata të ndryshme etj.

Aktiviteti nisi me: Hapjen e Portës Kryesore Të Portit Të Durrësit për publikun në orën 17:00.

dhe më pas vazhdoi me:

- Ekspozitë fotografike me foto te Portit Dje, në hyrjen kryesore të Portit.
- Vizita të hapura dhe të organizuara për publikun nëpër sektore të ndryshme të Portit.
- Performance e fëmijeve me titull “ PORTI YT” Femije te ftuar nga moshë 8-12 vjeç dhe nxenes te Liceut Artistik Jan Kukuzeli nën drejtimin e Shpresa Beqirit dhe Nikolett Vasise, pikturuan me ngjyra struktura me shkrimin “PORT YT”
- “Shfaqja për Fëmijë”, Nga ora 17:30 deri në orën 19:30 ku performuan artistë të moshave dhe fushave të ndryshme.
- Performance e zjarrfikseve të Portit të Durrësit. “Improvizimi i rënies së zjarrit në ambientet e brendëshme të Portit dhe masat që marrin Forcat e gatshme të zjarrëfiksive”
- Hapja e Ekspozitës së Arteve Vizuale Bashkohore.

Me pas aktiviteti vazhdoi me Koncert Pop-Rock me: këngëtare SAMANTA KARAVELLO dhe VEDAT ADEMI & BAND nga ora 20:00 deri në orën 23:00. Dj music non stop !!!... duke pritur lindjen e diellit në Portin e Durrësit.